



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS

GOVERNMENT OF KOSOVA

VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE MINIERAVE

MINISTRY OF ENERGY  
AND MINING

MINISTARSTVO ENERGIJE  
I RUDARSTVA

**Minutat e Takimit të 7-të ECCG, mbajtur me 02.10.2006**

Takimi i 7-të i ECCG-së i mbajtur me 02.10.2006 në MEM në sallën e takimeve. Lista e pjesëmarrësve gjendet në fletën e fundit të këtij procesverballi. Takimi u përshëndet dhe u udhëhoq nga z.Astrit Beqa Sekretar Permanent në MEM.

Agjenda e takimit është aprovuar dhe e bashkangjitur. Minutat e takimit të 7-të të ECCG –së u aprovuan në vijim.

**I. Rishiqimi i takimit të Ekspertëve i mbajtur në Vienë me 14-15 Shtator 2006**

z.Gëzim Pula, Drejtor i Departamentit për Strategji dhe Zhvillim në MEM ka prezantuar në Power Point ,prezantimin mbi zhvillimin dhe draft Konkluzionet të Ekspertëve ,mbajtur në Vienë me 14-15 Shtator 2006. Ai është fokusuar në aktivitetet e tanishme dhe çështjet që kanë të bëjnë (i) siguria afatshkurte e furnizimit, (ii) drafti MoU në aspektin Social dhe nevojat për MPMS që të merr udhëheqjen e këtij procesi, (iii) nevoja për zhvillimin e Road Maps për Energji Elektrike dhe Gas, (iv) aktivitetet e ardhshme, dhe (v) lista e nevojave për asistencë teknike për zhvillimin e MEM-it.

z.Pula shfaqti brengën e tij, të cilën poashtu e ka shprehur në Takimin e Ekspertëve në Vienë, që Kosova, sikurse shtetet tjera në rajon , nuk do të kenë mundësi të hapin tregun për energji elektrike për të gjithë konsumatorët josthtëpiakë deri në Janar 2008.

z.Beqa, Sekretar Permanent në MEM, i informoi pjesëmarrësit për themelimin e grupit punues për Traktatin e Komunitetit të Energjisë (ECT) në kuadër të MEM-it.

Ai e ftoi zonj .Lejla Uzicanin, të sigurojë informata dhe komente.

Zonj.Lejla Uzicanin e cila e udhëheq delegacionin e UNMIK-ut në Kosovë në Takimin e Ekspertëve na siguroi detajet e mëtejshme në zhvillimin e

Konkluzioneve në Takimin Ekspertëve në Vienë.Zonj.Uzicanin na informoi që Takimi i Shtatorit mbajtur në Vienë,  
Eshte quatur Takimi i Ekspertëve por atje kanë participuar anëtarët / reprezentatues të PHLG-së .

Ajo bëri të qartë komisionit të ECCG –së që Komuniteti Evropian nuk do ta mirëpres dhe me siguri nuk do ta pranojë kërkesën nga Kosova për shtyerjen nga afati I fundit të hapjes së tregut të Energjisë për të gjithë Konsumatorët jo-shtëpiakë deri më 01.Janar 2008.Ajo rekomandoi që procesi i hapjes së tregut në Kosovë të bëhet gradualisht derisa tregu të sigurojë detajet e arsyeshme dhe të argumentojë në lidhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë (ECT) në institucionet dhe forumet se si ata e kërkojnë.

Në lidhje me kërkesat e TA –së në kornizat e (ECT), zonj. Uzicanin theksoi nevojën për institucionet e Kosovës të paraqesin kërkesat për çfarëdo që institucionet kanë nevojë,

megjithëse të gjitha rastet nuk do të jenë të financuara.

eshte me rëndësi për ne të dijmë dhe zyrtarisht të qartësojmë çka na nevojitet.

Në lidhje me MoU për Qështjet Sociale ,zonj.Uzicanin informoi që kryesuesit e delegacionit Kosovar punuan mjaft që t'i bindin EC Reprerentatuesit që ky MoU të mos ketë “obligime të rënda” që vendet tona nuk mund të ballafaqohen .Në formën finale MoU prezanton vullnetin politik që të diskutojë dhe të merr në konsieratë Qështjen Sociale.

Në lidhje me sigurinë e furnizimit me energji , zonj.Uzicanin na informoi që delegacioni ynë në Takimin e Ekspertëve iu sqaroi reprezentatuesve tëve iu sqaroi reprezentatuesve të EC-së vështërsitë dhe rrethanat në të cilat ne operohet në Kosovë dhe i luti që ta kenë këtë në considerate.

z.Salvador Elmazi ,drejtot në departamentin e Energjisë propozoi që të shtojnë në listë nevojat e TA për studim / analizë për hapjen e tregut për energji elektrike dhe implikimin financiar për Kosovën duke përfshirë zhvillimin e listës për të punësuarit.

z.Muhamet Aliu ,Sekretar Permanent i MPMS ,shtroi një sër pyetjesh në lidhje me Draftin e MoU për Qeshtje Sociale .

Z.Pula dhe të tjerët u përgjigjën në pyetjet e parashtruara. z.Aliu u pajtua për nevojat e një bashkëpunimi të ngushtë në MEM-it ,dhe MPMS-it për zhvillimin e planit akcional në implementimin e acquis në mjedis. Ai u pajtua që të emërojë dhe mobilizoj stafin e tij të punoj në këto plane .MEM –i do të siguroj në hollësi ekspertiza afat - shkurte .

z.Mentor Morina nga MMPH bëri një sër pyetjesh në lidhje me sqarimin e tij dhe u zotua ta informojë Sekretarin Permanent të MMPH në mbledhjen që ishte present dhe nevojat për bashkëpunimin në mes MEM-it dhe MoU për qeshtje sociale. Kopja e MoU në versionin anglisht-shqip do ti dërgohet atij.

z.Vaso Leno ,iu propozoi pjesëmarrësve që ata të pajtohen me këto pika si vijon:

- KEK, ERO dhe KOSTT prezantuan nevojat për asistencë teknike në korniza të ECT-së për MEM-in ,kështu që pastaj MEM-i do të paraqes për shqyrtim tek ECT Sekretariatit në Vienë sipas agjendës me 15,Tetor 2006.
- MEM dhe MPMS do të punojnë së-bashku që të finalizojnë përgatitjet për nënshkrimin e Mou për Qështje Sociale , ashtu siq është planifikuar gjatë Takimit të ardhshëm të Ministrave që do të mbahet në Shkup ,kah mesi i Muajit Nëntor 2006 .Një konsulent i lartë i kualifikuar është i gatshëm të punojë me MPMS.
- Takimi prej KOSTT sikur coordinator nacional për monitorimin e sigurisë për qështje të furnizimit.KOSTT do t'ia paraqes MEM-it emrat dhe detajet e koordinatorit.

## **II. Rishiqimi i zhvillimeve aktuale në ERO dhe KOSTT**

z.Naim Bejtullahu ,Komisioner nga ERO ,nënvizoi se do të jetë më mire që tema e prezantimit nga ERO të shkruhet në agjendë. Pastaj ai mblodhi informata detale për aktivitete aktuale nga ERO, duke përfshirë kodet ,licencimet etj . Ai na informoi se:

(i) legjisllacioni sekondar është gati i kompletuar,(ii) kodet e prezantuara nga KOSTT do të aprovohen së shpejti ,(iii) në lidhje me pjesën e tretë ,KOSTT është në rrugë të mire,por distribuimi ballafaqohet me shumë vështërsi, (iv) ERO punon në modelin e tregut në tranzicion për energji elektrike ,(v) një numër i tregjeve të energjisë elektrike është i licencuar.,dhe (vi), raporti i pare i monitorimit është përfunduar.

z.Sabri Musiqi nga KOSTT-i na siguroi informata për statusin dhe zhvillimin e kodit të transmisionit,dhe vazhdimi i riparimit për tarifat e reja të transmisionit,siguria në furnizim etj. Ai i ritheksoi kërkesat e tij për ECT Institucionet që të intervenojnë për anëtarimin e KOSTT –it në SETSO (Task Force) e cila do të ri-zgjedh një numër të çështjeve të pritura që do të mund të ndikonin në operimet dhe të ardhurat e KOSTT-it . Kosova ende nuk do të jetë në gjendje të arrijë një marrëveshje me EMS në menaxhment të kapaciteteve të transmisionit në Kosovë . KOSTT parasheh që do të jetë e licencuar nga ERO në Tetor 2006.

## **III.Masat për sigurimin afat-shkurtër të furnizimit me energji**

Për shkak të mos-prezencës së përfaqësuesve të KEK-ut, informatat afatshkurte në lidhje me sigurimin për furnizim me energji që janë ndërrmarë nga KEK-u nuk janë siguruar në ECCG .Pjesëmarrësit në takim u pajtuan që MEM-i të kërkojë informatat nga KEK-u dhe që anëtarët e ECCG të kenë qasje në to.

## **IV. Rishiqimi nga ana e donatorëve**

Zonj.Lendita Gashi nga AER-i prezantoi shkurtimisht progresin e projekteve të TA-së të financuara nga AER-i ,e siq dihet AER-i planifikon që të përkah sektorin e energjisë dhe minierave në një periudhë afatmesme pas vitit 2006.

Ajo ritheksoi se AER-i është duke i përkrahur të gjithë **stakeholders** kryesorë në sektorin e energjisë me asistencë teknike.

Zonj.Gashi citoi që në takimet e PHLG në Qershor 2006 diskutimet janë bërë në investime rajonale për financimin e projekteve kapitale regjionale duke përfshirë linjën e interkoneksionit në mes Kosovës dhe Shqipërisë. Ajo pyeti se a ka ndonjë lajm në lidhje me këtë pikëpamje.

z.Astrit Beqa i informoi pjesëmarrësit që ka kërkuar përfshirjen e linjës së interkoneksionit me Shqipërinë si projekt prioritar në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës gjatë viteve 2007 – 2009. MEM-i do ta konsultojë KTA-në në këtë projekt.

z.Naim Bejtullahu e ngriti çështjen e nevojave për të dy shtetet (Kosovën dhe Shqipërinë) që t'i angazhojë formalisht në procesin e ndërtimit të linjës së interkoneksionit.

z.Vaso Leno I informoi që drafti i MoU në mes dy shteteve në linjën e interkoneksionit është e gatshme për nënshkrim nga ana e dy ministrave përkatës për energji.

## **V.Konkluzionet**

Gjatë takimit është arritur që:

- MEM, KEK, ERO DHE KOSTT të prezantojnë nevojat e tyre për asistencë teknike (TA) në Kornizën për Traktatin e Komunitetit të Energjisë (ECT). KEK, ERO, dhe KOSTT u pajtuan që të paraqesin nevojat e tyre për TA në MEM deri me 6,TETOR,2006, kështu që MEM të mund të përpilojë nevojat e Kosovës për TA në një document formal që t'i paraqes për shqyrtim tek ECT Sekretariatit në Vienë sipas agjendës me 15,Tetor 2006.
- MEM dhe MPMS do të punojnë së-bashku që të finalizojnë përgatitjet për nënshkrimin e MoU për çështje sociale ashtu siq është planifikuar gjatë Takimit të ardhshëm të Ministrave që do të mbahet në Shkup kah mesi i Muajit Nëntor 2006. MPMS do ta udhëheq implementimin e MoU në Qështje Sociale
- MEM dhe MMPH do të punojnë së-bashku në zhvillimin e Planit Akcional dhe orarin për implementimin e acquis në mjedis.
- Takimet prej KOSTT-it si koordinator nacional për monitorimin e sigurisë për çështjet e furnizimit .KOSTT do t;ia paraqes MEM-it në detaje emrat dhe kontaktet me koordinatorë.

## **VI. Data e Takimit të ardhshëm**

Takimi i ardhshëm do të jetë para fundit të vitit 2006. Data dhe dita do të vendosen nga Sekretari Permanent i MEM-it pas PHLG Takimit në Vienë me 16

– 17 Tetor 2006. MEM / EPTISA do të jenë përgjegjës për organizimin e këtij takimi.

**Pjesëmarrësit**

Organizatrat e Kosovës

UNMIK                zonj.Uzicanin

MEM                z. Astrit Beqa,z.Gëzim Pula, z.Salvador Elmazi, zonj.Arbene Aliu,  
z.Hajrullah Shehu

MMPH    z.Muhamet Aliu Sekretar Permanent

MPMS    z. Mentor Morina

KOSTT    z.Sabri Musiqi , Resmije Ahma

ERO    z.Naim Bejtullahu, z.Azem Kastrati

Donatorë:

AER    zonj.Lendita Gashi

AER Konsulent

Eptisa                z.Vaso Leno, zjj. Helene Ryding

Minutat u përgatitën në versionin shqip nga:

**Arbene Aliu dhe Hajrullah Shehu**

ECCG Sekretariati

ECCG



INSTITUCIONET E PËRKOSSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS

GOVERNMENT OF KOSOVA

VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE MINIERAVE

MINISTRY OF ENERGY  
AND MINING

MINISTARSTVO ENERGIJE  
I RUDARSTVA

**Zyra e Sekretarit të Përhershëm**

**MBLEDHJA E SHTATE E GRUPIT TE KOSOVES PER TRAKTATIN E  
ENERGJISE PER EVROPEN JUGLINDORE**

**2 Tetor 2006, ora 13:00, ne Ministrinë për Energji dhe Miniera**

**AGJENDA**

- |   |   |                                       |
|---|---|---------------------------------------|
| 1 | Mirëseardhja  | Z. A Beqa, Sekretar i Përhershëm, MEM |
| 2 | Miratimi i Agjendës   |                                       |
| 3 | Aprovimi i Minutave të Mbledhjes së 6 të Grupit   |                                       |
| 4 | Informim mbi Takimin e Ekspertëve në Vjenë në Shtator 2006 – Obligimet e Traktatit për Kosovën gjatë 2006-2007 (Aktivitetet në proces: Hapja e tregut (konsumatorët e kualifikuar), Memorandumi për Ceshtje Sociale; "Road Maps" për sektorët e energjisë elektrike dhe gazit) Aktivitetet për të ardhmen | Z. Gezim Pula, MEM                    |
| 5 | Informim për zhvillimet aktuale   | ZRrE dhe KOSTT                        |
| 6 | Masat për sigurinë e furnizimit në rryme për periudhën afatshkurtër   | Zj. Pranvera Dobruna, KEK             |
| 7 | Informim nga donatorët  | Banka Botërore, USAID<br>AER          |
| 8 | Ceshtje të tjera  |                                       |
| 9 | Data e takimit të ardhshëm dhe mbyllja  |                                       |